




Bazuar në nenin 108/A të LPP 05/L-068, Zyra e prokurimit , më datën 18.02.2020 , (ne afat ligjor – vikendi dhe dita e pavarësisë) , ~~ne pergjigje te~~ Kerkeses per Ri-Shqyrtim te O.E “ ARHIKO ING ” nga Prishtina te postuar perms e- prokurimit me date 14.02.2020 , merr këtë

VENDIM



HIDHET POSHT , kërkesa e O.E. “ARHIKO INGA “ , nga PRISHTINA , me të cilin Ka paraqitur Kerkese per Ri-Shqyrtim ne Njoftimin e A.K per Dhenje te Kontrtaes , te dates 12.02.2020 , ne Prokurimin nr. 634-19-502-221 /nr. Interno 634-19-008-221“ Hartimi i Projeketve Zbatuese –Ekzekutive “ Ri –Vleresim “

Arsyetim

1.

O.E “ Arhiko Ing “ nga Prishtina , Ne Kerkesen e tij ka Numruar nenet e pretenduara qe jane shkelur nga A.K., qe jane : Neni 7 , Neni 13, Neni 59 , Neni 65 , Neni 66, Neni 69, Neni 71, dhe Neni 72 i LPP.

Si dhe Nenin 9 dhe Nenin 57 te Ligjit te Punes ,Nr.03-L-212

Pikat 1.10,1.12,1.13,1.14,1.15 dhe 1.16 te Ligjit per te Huajet , Nr.04/L-219

2.

1. Pretendimi i Ankuesit pika A-Shkeljet qe jane ngarkuar neve (Aludimi i O.E) se eshte Eliminuar se nuk ka prezantuar Inxhinier te Infrastruktures rrugore , dhe Nuk ka prezantuar Agronom apo kimist Pergjigje :

Ky pretendim eshte i shqyrtuar me kujdes nga Experti ne ekspertizen e dhene dhe ne Vendimin e OSHP nr. 384-406/19 te dates 27.08.2019, ku thuhet : Bashakangjitur faqe 4, faqe 5, dhe faqe 6 e vendimit .

2. Ne pretendimin nr. 1 ,qe ne Oferten e fituesit ka gabime ne llogaritje , Vendimi OSHP , bazuar ne Raportin e Expertit ,nr. 384-406/19 i dates 27.08.2019 , faqe 2 e vendimit ka Konstauar se nuk ka gabime ne llogaritje .Dhe pretendimi eshte i papazuar ku edhe Paneli ne Vendimin e tyre ka vërtetuar kete . Ju dokumentojme faqen 6 te Vendimit . Keto pretendime jane analizuar dhe hudhur te paqëndrueshme edhe ne Vendimin nr.931-19 te dates 03.02.2020 te OSHP-se

3.Derisa per Pretendimin nr. 2 per Ofertuesin fitues qe nuk ka Menaxherin e kontates , Kjo nuk qendron , meq Ne Dokumentacionin qe edhe mund te shihet ne platform e- prokurimi qe nga Oferta e dorzuar , pos Memorandumit te marrëveshjeve se konzorciumit deklaratat pe obligimet e cdonjerit si dhe Deklaratane e Menaxherit e Neneshkruar nga te tre Anetaret e konzorciumit . Shihet se Jane te Scanuara nga Origjinali .

Dhe per Fund : Ligji i punes dhe Pagat jane sqaruar ne Kerkesen per dokumente shtese ku ka Prezentuar se vlera e kompensuar prej 150, 00 Euro eshte pune part time vetem per kete projekt derisa pagen primare ata e kane ne ndërmarrje tjera .

E derisa pretendimi per te Huajet , Kjo nuk ishte qeshtje e kësaj proceduræ . Problematikat si punësohen apo kush punësohet bazuar ne Statusin e Ndermarrjes A.K .nuk e ka ne domen e as ne shqyrtim. Ne kemi kërkuar stafin , Kualifikimet dhe pervojen e punes , derisa se si eshte punësuar eshte qeshtje e O.E.

Këshilla juridike

Pala e pakënaqur bazuar në pjesa IX të LPP dhe nenit 109 ka të drejtë ankese në afatin ligjor në OSHP.

.Zyrtari pergjegjes i prokurimit
Abaz Foniqi

Vendimit I bashakngjesim

- Vendimin e OSHP nr. 384-406-2019 I dates 27.08.2019 faqet 4-5 dhe 6
- Vendimin e OSHP nr 934-19 I dates 03.02.2020 faqe 3 faqe 4 -5 dhe faqe 6
- Vendimin e Menaxherit te projektit

nuk ka qene i vendosur ne dosjen e tenderit, andaj autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-se ku parashihet si ne vijim "Tenderuesi gjate procedurave te hapura ose kandidati gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla ne baze te një kërkesë ose kriteri qe nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit".

Autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet te prokurimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se dhe ne kundërshtim me nenin 44.7 dhe 8 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara ne këto dispozita nuk janë përmbushur ne këtë rast. AK duhet te respektoj nenin 7, nenin 59 .Ky pretendim qëndron dhe AK duhet te kthej lenden ne rivlerësim

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e datës: 25.07.2019, ka sqaruar pretendimet e OE ankues, "Arhiko.ing" OP-Prishtinë, ku AK ka bere shkelje ligjore qe ka eliminuar dhe ka anuluar procedurën e prokurimit. Arsyeimi i pare qe nuk kemi ofruar inxhinier te kimisë por te biologjisë nuk qëndron sepse ne dosje është specifikuar qe inxhinieri duhet te jete i licencuar për raport te VNM dhe është kërkuar qe për këtë inxhinier te këtë vetëm licencën e noterizuar e jo diplomën ose kualifikimin universitar. Kjo le te kuptohet qe AK nuk i ka interesuar kualifikimi por licenca e VNM. Po ashtu kimisti dhe biologu janë dege te FSHMN-se. Në punët që parashihen është e domosdoshme raporti VNM dhe kjo nuk ka rëndësi se a është kimist apo biolog me rëndësi ka kualifikimi i nevojshëm për përpilimin e raporteve të VNM. Me eliminimin tonë AK ka bërë shkelje të nenit 59 të paragrafit 4 ku thuhet: 4. Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm, nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara të njoftimit në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, Autoriteti Kontraktues mund të konsideroj një tender si të përgjegjshëm: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material ose aspektin e tenderit në fjalë ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime të materialeve ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që çfarëdo devijimi i mundshëm të kuantifikohet, aq sa është e mundshme dhe të merret parasysh gjatë krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve". Me rastin konkret dosja jonë përmban vetëm një devijim të vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale apo devijime në karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e parashtruara nga AK-ja.

Eksperti i OSHP-se sqaron se: Lidhur me pretendimin e OE ankues është i paqëndrueshëm sepse kërkesa e AK-se ka qene: "Një agronom i diplomuar apo kimist. Për agronomin apo kimistin edhe licenca për

Ndikim te mjedisit (VNM). (Bachelor ose master). Licenca duhet te jete e noterizuar” Pra, OE ankues nuk e ka plotësuar ketë kriter sepse është kërkuar Agronom ose Kimist te diplomuar bachelor ose master) dhe me licence për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM), dhe qe OE ankues e ka sjellë biolog, qe do te thotë se ka plotësuar kriterin e AK-se. Pra, nuk plotëson ky kriter nga OE sipas kërkesave te Njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit.

Eksperti i OSHP-se sqaron se : Sa i përket inxhinierit të infrastrukturës rrugore, ju në dosje të tenderit e keni cekur si vijon: Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master drejtimi Infrastrukturë rrugore me përvojë pune në projekte minimum 5 vite. Ky kriter është i qarte se është kërkuar Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master ne infrastrukture rrugore ; (kriteri është shume i qarte se për çfarë inxhinieri kërkohet për rruge). Kjo është sqaruar edhe ne njoftimin e OSHP-se dhe ekspertizës nr.212/19. Pretendimi i OE ankues nuk qëndron sepse kjo është shume e qarte dhe nuk ka arsye për devijim te kriterit, kur kriteri kuptohet se çfarë është kërkuar Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë – konstruktiv.

Eksperti i OSHP-së sqaron se: OE ankues lidhur me ketë kriter ne dosjen e OE se propozuar gjendet : Luljeta Ajdini e cila me profesion është biologe, por është e licencuar për NVM, pra kriteri i kërkuar i AK ka qene agronom apo Kimist, por OE i rekomanduar ne stafin e tij e ka me profesion (profesor i Biologjisë – Luljeta Ajdini). Pretendimi i OE në lidhje me diplomën është i bazuar, pasi qe nuk e përmbush kriterin qe te jete Kimist apo agronom, por kandidatja është e licencuar nga Ministria e Mjedisit te Kosovës për NVM.

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE ankues nuk e ka në listën e stafit sipas kriterit të kërkuar “Një inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune në projektin minimum 5 vite”, por ka inxhinier të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv (Ibrahim Selishta). Pra, kërkesa e AK-së nuk përmbushet siç është kërkuar ne FDT. Sa i përket drejtimeve siç pretendon OE ankues mund ta shikoj ne web faqen e UNIVERSITETIT TE PRISHTINES-FAKULTETI I NDERTIMTARISE (<https://fna.uni-pr.edu/Departamentet.aspx>) ka katër drejtime: Konstruktiv, Hidroteknik, gjeodezi dhe Infrastrukture rrugore, dhe kriteri i kërkuar i AK-se Pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në platformën e prokurimit e ka vendosur çmimin e poentuar të ofertës 0.631 €, edhe ne përshkrimin e çmimeve te FDT-së OE “Arhiko.ing” e ka vendosur çmimin për njësi, ku çmimi i poentuar është 0.631 €. Pra, nëse marrim dhe i krahasojmë çmimin njësi që OE ankues e ka bashkangjitur në platformë te Pjesa II- Përshkrimi i çmimeve nuk përputhet me Formularin C, sepse në formularin C OE i propozuar ka shënuar 0.631 €, por nëse e marrim para masën te totali i para masës (me TVSH) duhet të jetë 1.98 €, kurse OE e ka vendosur çmimin e peshuar 0.65 €,

kurse vlera e TVSH-se ne formularin e bashkangjitur ne EXCEL te OE. "Arhiko.ing" te propozuar është ne katër (4) pozicione (poz.1,2,3,5) totali i TVSH-së është 0.00 €, kurse me një pozicion (poz.nr.4) është 0.09 € por duhet te jete vlera e TVSH-së 0.35 €, kurse vlera totale me TVSH duhet të jetë 1.98 €, dhe pastaj mund te vendoset çmimi i poentuar, e jo siç ka vepruar OE. "Arhiko.ing" Pra, përputhet çmimi i poentuar ne Formularin e Tenderit dhe në Përshkrimin e çmimit, por nuk përputhet me formatin EXCEL, sepse ne versionin EXCEL ka qene dashtë te vendoset totali i çmimeve për pozicione qe duhet te jete 1.98 €, e jo sic ka vepruar OE. "Arhiko.ing" – 0.65 € Ne tabelën ne Excel ka qene dashtë te jene këto vlera: totali i poz.1 = 0.08 €; totali i poz.2 = 0.08 €; totali i poz.3 = 0.07 €; totali i poz.4 = 1.67 €, dhe totali i poz.5 = 0.06 €, qe ne subtotal është 1.96 €, totali i TVSH për këtë vlere ka qene dashtë te jete 0.35 €, e jo siç e ka vendosur OE vlerën e TVSH-se.

Pra, bazuar ne këto sqarime te paraqitura me lartë rezulton se ka mos-përputhje të ofertës sepse OE. "Arhiko.Ing" ka shënuar ne formularin C – 0.65 €, dhe te tabela e EXCELIT (qe duhet te jete Totali i vlerës i paraqitur ne këtë tabele). Pra, duke u bazuar në nenin 39.8 të RrUOPP dallimi i vlerës tejkalon vlerën e lejuar +/-2%. Pra, bazuar ne pretendimin ankimor te OE ankues mendojmë se OE "Arhiko.ing" nuk e ka plotësuar siç duhet tabelën por e ka vendosur çmimin e poentuar Pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar. AK duhet te ketë parasysh dhe te trajtohen gjithë OE sipas kriterëve te kërkuara ne Njoftim për kontrate dhe FDT sipas nenit 7, nenit 59. AK duhet te merr parasysh Njoftimin e OSHP-së, nr.212/19, ashtu siç është pajtuar me raportin e ekspertizës nr.212/19, ne te kundërtën përgjegjësia ligjore bie mbi zyrtarin përgjegjës te prokurimit.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues nr.384/19 të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet ankimore te paraqitura ne raport), dhe ankesa nr.406/19 e pabazuar, dhe propozojmë që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues -KK-Klinë, me datë: 31.07.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik -"PROing&Partners" shpk-Prishtinë, me datë: 28.07.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Arhiko.ing" OP-Prishtinë, me datë 26.07.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar

Çmimi i përgjithshëm i peshuar (ofertat duhet të vlerësohen në baze të kësaj vlere). Kjo është vlere e cila do të duhej të vlerësohet në baze të kësaj vlere). Kjo është vlere e cila do të duhej të vlerësohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike. Keni të bashkangjitura edhe informacionet shtesë të dërguara nga AK:

INFORMACION Parametrat në dosjen e tenderit dhe përshkrimi i çmimeve në Tabelën e çmimeve në Excel janë identike. Ndryshim ka në atë në paramasën dhe përshkrimi i çmimeve në dosje janë të ndara në të gjitha pozicionet në grupime, për të dhënë çmime në çdo pozicion veç e veç e që në fund të jete çmimi total i grupimit. Deri sa në Përshkrimin e çmimit në tabelën Excel është totali i vlerës së grupimit për të u vlerësuar me piket e përcaktuara. Çdo grupim ka të përshkruar detyrat që janë për tu kryer si në dosje ashtu edhe në çmime, Andaj çmimi i dal në total të grupit vendoset në çmimin total të grupit dhe rezultati do të vlerësohet për Totalin e grupit e në tërësi për piket e fituara në totalin e tenderit. Në çmime në platformë përshkrimi i çmimit në Tabele për të gjitha grupimet është "Shënimi i Autoritetit Kontraktues: Ku është njoftuar teksti "Totali i Përgjithshëm i _____% për vlerësim. Totali me TVSH. Nga kjo shihet qartë se AK në dosjen e tenderit dhe në dokumentin për informacione shtesë e qartëson se çmimi i lexuar gjatë ofertave dhe vlerësimit të tenderëve ka kërkuar që të jete çmimi i peshuar dhe i poentuar me pikë.

Nuk e dimë se pse AK edhe në herën e parë që na ka përzgjedhur fitues dhe dy herat e tjera e vlerëson dhe publikon çmimin total të papeshuar me piket e përcaktuara me përqindje. Nga kjo që u tha më lartë mendojmë se AK ka bërë shkeljen të nenit 7.59, dhe 65 të LPP-së. Eksperti i OSHP-së lidhur me pretendimin e parë ankues sqaron se: OE i rekomanduar për kontratë në procesverbalin e hapjes ka vendosur çmimin 5.75 €, kurse në Formularin e Tenderit ka vendosur çmimin e poentuar sipas kriterëve që i ka vendosur AK që të vendoset çmimi i poentuar dhe OE ka vendosur çmimin e poentuar 1.18 €. Pra, OE ankues pretendon se nuk përputhet çmimi ofertues dhe të vlerësuar. Pra, AK ka potencuar se në vlerësim merret parasysh çmimi i poentuar. Këtë edhe AK në proceset e vlerësimit që i ka pasur s'ka patur asnjë paqartësi që me këtë kuptohet se është plotësuar kërkesa e AK-së. AK i ka vlerësuar ofertat e gjithë OE dhe i ka respektuar edhe vendimet e OSHP-së. Ne mendojmë se nuk ka ndonjë paqartësi pasi që në procesverbal ka vendosur çmimin pa poentim, kurse në FDT ka vendosur çmimin me poentim. Po të llogaritet sipas formulave që i ka kërkuar AK përputhen dy çmimet.

Psh. Pa poentim Poentimi çmimi me poentim Tabela A – 3.22 € 10 % 0.322 € Tabela B – 0.08 € 10 % 0.008 € Tabela C – 1.06 € 35 % 0.371 € Tabela D – 1.36 € 35 % 0.476 € Tabela E – 0.03 € 10 % 0.003 €
TOTALI – 5.75 € 100 % 1.18 €

Pra, në Njoftim për Kontratë kërkohet (citim): Kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i ulët me poentim sipas kësaj: A-Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore -Ndërtimi i lartë (Objekte publike

shkolla, çerdhe, objekte administrative- kulturor, salla sportive, palestra sportive etj)..... Totali i projektimit te objekteve (10% e pikëve për vlerësim).

B. PROJEKTETE PËR RENOVIMIN E OBJEKTEVE -Ndërtimi i lartë (Objekte publike shkolla, çerdhe, objekte administrative- kulturor, salla sportive, palestra sportive etj) Totali i projektimit te objekteve(10% e pikëve për vlerësim). T C.RRUGËT DHE OBJEKTET E RRUGËS Totali i projektimit te objekteve(35% e pikëve për vlerësim) D. Projektimi i

trajtimit te ujërave, ujësjellës dhe Totali i projektimit te , dhe projekte tjera te ndryshme (35% e pikëve për vlerësim . E. Totali i projektimit te KANALEVE TE UJITJES , URAVE , LESHESAVE , PRQEVER DHE HAPSIRAVE PUBLIKE10% e pikëve për vlerësim. Nëse ndodhe qe vlerat e dy apo me shume ofertave do jene te njëjta , Përparësi do ketë Vlerat e Referencave per projekte me kërkuara . Ne FDT, kriteri kërkohej: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët Me poentim. Nuk ceket askund se edhe ofertimi duhet të jetë me poentim, por thuhet se kriteri i dhënies është çmimi më i ulët me poentim. Nuk mendojmë që është ndonjë gabim pse OE ka ofertuar me çmim njësi pa poentim, por paramasen e ka plotësuar me çmim me poentim.

Mendoj se pretendimi ankimor për këtë pikë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues në lidhje me këtë pikë: Arsyetimi i dytë që nuk kemi ofruar inxhinier të Agronomisë apo të Kimisë po të Biologjisë nuk qëndron sepse në dosje ju keni specifikuar se inxhinieri duhet të jetë i licencuar për raport të NVM-së dhe në FDT është kërkuar të ketë vetëm licencën e noterizuar e jo diploma ose kualifikimi universitar. Kjo le të kuptohet që AK nuk i ka interesuar kualifikimi por Licenca e NVM-së për punët e kërkuara në paramasë pasi që Agronomi apo Kimisti janë dy profesione të ndryshme që dallojnë shumë në kualifikimin profesional. Po ashtu kimisti dhe biologu janë dy degë të FSHMN-së. Në punët që parashihet është e domosdoshme raporti i VNM-së, dhe kjo nuk ka rëndësi se a është kimist apo biolog me rëndësi ka kualifikimin e nevojshëm për përpilimin e raporteve të VNM. Me eliminimin tonë AK ka bërë shkelje të nenit 59 paragrafi 4 ku thuhet: 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhje me këtë pretendim ankimor e sqaron Vendimi i PSH 384/19 &

406/19 Citim: "Paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar pasi që kërkesa e AK-së ka qenë: "Një agronom i diplomuar apo kimist". Për agronomin apo kimistin edhe licenca për ndikim në mjedis (NVM). Bachelor ose master. Licenca duhet të jetë e noterizuar dhe OE ankues lidhur me këtë kriter ka prezantuar : Luljeta Ajdini e cila me profesion është biologe, por e licencuar për NVM, pra kriteri i kërkuar i AK-së ka qenë agronom apo Kimist. Pretendimi ankimor i pabazuar (pasi që e ka qartësuar vendimi i Panelit shqyrtues të OSHP-së nr. 384/19&406/19).

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, siç e ka paraqitur OE ankues si shkelja 3 Shkelja 3. Në rastin konkret dosja jonë përmban vetëm një devijim të vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e parashtruara nga AK.

Sa i përket inxhinierit të Infrastrukturës rrugore, ju në dosjen e tenderit keni cekur si vijon: Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose MASTER Drejtimi Infrastrukturë rrugore, me përvojë pune në projektim minimum 5 vite. Ju keni lënë opcion të hapur ose Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master drejtimi Infrastrukturë rrugore. Ne në këtë dosje kemi ofruar si staf Inxhinierin Ibrahim Selishta, i cili ka kryer provimet edhe në infrastrukturën rrugore dhe ka përvojën e duhur për dizajnimin e rrugëve. Si dëshmi për kualifikimin e tij kem bashkangjitur diplomën e tij, CV-në si dhe referenca për punë në infrastrukturë rrugore. Në sistemin 3+2 janë të ndara drejtimet dhe një master drejtimi konstruktiv ose hidroteknike nuk mund ti kryej punët e infrastrukturës rrugore sepse nuk janë kompetent.

Nga gjithë kjo që u tha më lartë, ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme për kërkesën tuaj. Për informata tjera mund të kontaktoni edhe fakultetin e ndërtimtarisë dhe arkitekturës dhe të merrni dëshmi se inxhinieri i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv me sistem 5 vjeçar plotëson kushtet e inxhinierit të infrastrukturës rrugore. Rrjedhimisht AK ka bërë shkelje të nenit 59, nenit 65 dhe nenit 69 të LPP. Më poshtë gjeni të bashkangjitur listën e stafit. Në rastin konkret dosja jonë përmban vetëm një devijim të vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e parashtruara nga AK. AK duhet të ketë edhe anën ekonomike të ruajtjes së buxhetit të qytetarëve pasi që devijimet e vogla pasi që edhe ligji i jep të drejtë që të ketë kursim të mirë dhe ti kryej punët sipas planifikimeve. Kjo len të kuptoj se AK nuk e ka përfill fare Ligjin dhe të kursej buxhetin e vet. Rrjedhimisht AK ka bërë shkeljen e nenit 59, nenit 65 dhe nenit 69 të LPP-së. Eksperti i OSHP-së sqaron se kriteri i kërkuar i AK-së Te kërkesa është : . Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Infrastrukture Rrugore - me përvojë pune në projektim minimumi 5 vite pas Te dëshmia: Dëshmia 1 Lista e stafit profesioanl te paraqitet origjinal e nënshkruar dhe e vulosur. Për stafin profesional duhet te prezantohen • Diplomat (e noterizuar origjinale); • Cv-të (origjinal + të nënshkruar nga vetë pala); • Referenca ne hartim te projekteve • Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i

rregullt profesional ose Para-kontrata e punës për projektin në fjale për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik ; • Një deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëlosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1. OE ankues në dosjen e tij ka të bashkangjitur Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, por kërkesa e AK-së është Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore - me përvojë pune në projektim minimumi 5 vite pas diplomimit.

Si ekspert mendoj se sipas kërkesës së AK-së në hartim të projekteve duhet të ketë Inxhinier të profileve të ndryshme e jo të zëvendësohen siç pretendon OE ankues. Por në projekt janë kërkuar inxhinier të profileve të ndryshme, pasi që sipas kërkesës së AK-së projektimet duhet të bëhen sipas nevojës që ka AK-ja, pra nevojitet për: a) Arkitekturë, b) Rrug(ë)ica, c) Kanalizim/e d) Elektroteknikë-ndriçime, etj Por pasi që AK nuk e ka precizuar apo e ka lënë të paqartë, sepse do të duhej të ishte: “Inxhinier i diplomuar – Infrastruktura rrugore ose Master i Infrastruktura rrugore”, por lëshimi i AK-së, nuk e obligon OE të ketë patjetër Infrastruktura rrugore. Pra, kërkesa e AK-së është “Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore - me përvojë pune në projektim minimumi 5 vite pas diplomimit” Mendoj se si pretendim është i pjesërishtem pasi që AK duhet të jep **versionin** e saj se si e ka menduar këtë kriter. Pretendimi ankimor i pjesërishtem.

Lidhur me pretendimin ankimor, siç pretendon OE ankues Shkeljet e AK në lidhje me shpalljen e fituesit të këtij tenderi AK në shumë pika ka shkelur Ligjin; 1. AK ka bërë shkelje ligjore në vendimin e shpalljes së fituesit, ka rënë ndesh me kërkesën në Fletën e të Dhënave të Tenderit ku ka kërkuar që çmimi të jetë i peshuar, ndërsa fituesi që AK ka shpallur ofertën me çmimin e papeshuar. Rrjedhimisht AK ka bërë shkelje të nenit 59, nenit 65 dhe nenit 69 të LPP-se. 2. Për Inxhinierin e ndërtimtarisë Shaban Idrizi ka ofruar diplomën në gjuhën maqedone dhe vendbanimi i tij është në Maqedoni Për këtë duhet leje qëndrimi dhe leje pune në Republikën e Kosovës duke u bazuar në: LIGJIN e Punës 03-L-212 Neni 9 Punësimi i shtetaseve të huaj Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas këtij ligji, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare. 1.9. Leje qëndrimi – çdo autorizim i lëshuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës që lejojnë qëndrimin e ligjshëm të të huajit në territor, me përjashtim të: 1.9.1. vizave; 1.9.2. lejeve të lëshuara në pritje të shqyrtimit të kërkesave për leje qëndrim apo azil. 1.10. Qëndrimi i paligjshëm –prezenca e të huajit në territorin e Republikës së Kosovës i cili nuk i plotëson, apo nuk i plotëson më kushtet për hyrje apo qëndrim në Republikën e Kosovës; 1.12. Marrëdhënia e punës– ushtrimi i aktiviteteve që mbulojnë çfarëdo forme të punës të rregulluar me ligjet e aplikueshme ose në përputhje me praktikën e përcaktuar, për/ose nën drejtimin dhe/ose mbikëqyrjen e një punëdhënësi; 1.13. Punëdhënësi – personi fizik ose juridik, duke përfshirë Agjencinë e Përkohshme të

Me dt: 20.03.2018

Per: **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

Titulli i kontratës: „ **HARTIMI I PROJEKTEVE ZBATUESE -EKZEKUTIVE “**

Nr. i Prokurimit: **634-19-502-2-2-1**

Nr. i Brendshëm: **634-19-008-221**

Ne koncerziumi: **“PROing&Partners”SH.P.K&Engineering Group “ Sh.p.k& N.SH. “GEOCAD”**

DEKLARATE MBI MENAXHERIN

Deklarojmë se **z. Isak Idrizi** me profesion *inxh. i dip. i Ndërtimtarisë(Konstruktiv)* është caktuar menaxher i projektit(kontratës) të lartëcekur, dhe marrim në përgjegjësi të plotë dhe garantojmë se do ti kryejmë punët sipas specifikacionit të kërkesave.

Palët e marrëveshjes:

“PROing&Partners”SH.P.K

Kujtim ZENA
Pronar i Kompanisë



Engineering Group " Sh.p.k

Artan Dautaj
Pronar i Kompanisë



N.SH. “GEOCAD”

Fidan Hasaj
Pronar i Kompanisë

